



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:246833
Datë: 19.03.2024
Numri i dokumentit: 05469902

PPP.nr.216/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përmbaremore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESco), me seli në Prishtinë, rr “Bulevardi Bill Clinton”, nr.5, kundër debitorit S.H. nga fsh ..., komuna e Ferizajt, me numër personal të Inj....., për pagesën e borgjit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 19.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I.PRANOHET pjesërisht prapësimi i debitorit S.H., i ushtruar kundër urdhrorit për përmbaremore P.nr.333/2019, i datës 19.06.2019, i lëshuar nga Përmbareuesi privat M.Sh. nga Ferizaj, sa i përket shumës së borxhit prej 2,782.90 euro të kërkuar nga kreditori në propozimin për përmbaremore shumë e cila rrjedh nga data 13.10.2014 e deri më datë 11.05.2018 dhe **SHFUQIZOHET** dhe **Lihet** jashtë fuqisë juridike urdhri për përmbaremore P.nr.333/2019, i datës 19.06.2019, sa i përket shumës së borxhit prej 2,782.90 euro, për shkak të parashkrimit.

II.REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit S.H., i ushtruar kundër urdhrorit mbi lejimin e përmbaremit P.nr.333/2019, i datës 19.06.2019, i lëshuar nga përmbareuesi privat M.Sh. nga Ferizaj, sa i përket shumës së borxhit prej 590.96 euro borxh i cili rrjedh nga data 11.06.2018 e deri më datën 12.06.2019 dhe për shpenzimet e procedurës përmbaremore dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përmbaremit P.nr.333/2019, i datës 19.06.2019, për shumën e borxhit prej 590.96 euro dhe për shpenzimet e procedurës përmbaremore.

A r s y e t i m

Me urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.333/2019, të datës 19.06.2019, përmbaruesi privat M.Sh., e ka caktuar përmbarimin e propozuar sipas propozimit të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESco), me seli në Prishtinë, kundër debitorit S.H., për pagesën e shumës së borxhit prej 3,373.86 euro, në bazë të ekstraktit të librave afariste me numër DFE ..., të datës 18.06.2019, si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbarimore, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe nga xhirollogaria e debitorit të barten në xhirollogarinë bankare të përmbaruesit privat ose regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajshme dhe të paluajshme të debitorit.

Kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që ta pranoj prapësimin dhe ta anuloj në tërësi urdhrin për përmbarim.

Kreditori ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit me të cilën i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim P.nr.333/2019, i datës 19.06.2019.

Gjykata në këtë rast i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin mbi lejimin e përmbarimit dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi në fjalë është:

Pjesërisht i bazuar

Gjykata me rastin e rishikimit të procedurës së përmbarimit në bazë të nenit 43, par 4, të LPP-së, vlerësoj se urdhri mbi lejimin e përmbarimit P.nr.333/2019, i datës 19.06.2019, i lëshuar nga përmbaruesi privat M.Sh. nga Ferizaj, është pjesërisht i ligjshëm dhe i rregullt, përkatësisht është i ligjshëm sa i përket shumës së borxhit prej 590.96 euro dhe shpenzimet e përmbarimit kurse nuk është i ligjshëm sa i përket shumës së borxhit prej 2,782.90 euro, për shkak të parashkrimit.

Sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se: ky borxh është i vjetërsuar dhe i parashkruar sipas dispozitave të LMD-së, Gjykata këtë pretendim të debitorit e konsideron pjesërisht të bazuar ngase me rastin e shikimit të ekstraktit të verifikuar nga librat afariste gjykata ka konstatuar se faturat nga data 04.04.2013, e deri më datën 11.05.2018, janë fatura të cilat janë parashkruar, vjetërsuar në bazë të nenit 361, par 1, nën par 1.1, të LMD-së, në të cilin është paraparë: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe*

për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”, kurse faturat nga data 11.06.2018, e deri më datë 13.05.2019, që kapin shumën e mjeteve prej 590.96 euro, janë fatura të cilat nuk janë parashkruar konform nenit 361, par 1, nën par 1.1, të LMD-së, ngase në bazë të propozimit për përmbarim të kreditorit shihet se kreditori propozimin për përmbarim e ka dorëzuar tek përmbaruesi privat më datë 19.06.2019, që nënkupton se propozimin për përmbarim kreditori e ka ushtruar brenda periudhës kohore prej një viti.

Gjithashtu, gjykata me rastin e llogaritjes së faturave të cilat janë parashkruar dhe faturave të cilat nuk janë parashkruar, të cilat janë sqaruar më lart, ka ardhur në përfundimin se shuma e mjeteve prej 2,782.90 euro është shumë e mjeteve e cila i përket faturave të cilat janë përfshirë në parashkrim, gjegjësisht periudha kohore e cila është përfshirë në parashkrim është nga data 13.10.2014 e deri më datë 11.05.2018, kurse shuma e mjeteve prej 590.96 euro, për periudhën kohore prej datës 11.06.2018 e deri më datën 12.06.2019, është shuma e cila i përket faturave të cilat nuk janë të përfshira në parashkrim.

Po ashtu, gjykata konstaton se fakti se në këtë rast në ekstraktin nga librat afariste figurojnë dy pagesa të ndryshme të energjisë elektrike në llogari të debitorit, nuk nënkupton se debitori e ka pranuar borxhin që e ka ndaj kreditorit, ngase që të dy këto pagesa, siç është pagesa e shumës së mjeteve prej 138.94, e bërë më datë 29.06.2018 dhe pagesa e shumës së mjeteve prej 121.78 euro, e bërë më datë 12.07.2017, janë pagesa të ndryshme dhe të papërcaktuara dhe nuk lënë të kuptohet se për cilën periudhë kohore janë paguar, dhe aq më parë kur dihet se këto pagesa nuk janë bërë nga vet debitori por janë bërë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, po ashtu nga shkresat e lëndës nuk shihet se në mes të palëve ndërgjyqëse ka ekzistuar ndonjë marrëveshje që borxhi të paguhet me këste.

Si përfundim, Gjykata duke i marr parasysh thëniet e debitorit në prapësim, përgjigjen e kreditorit në prapësimin e debitorit, provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, përkatësisht e pranoj prapësimin e debitorit si të bazuar sa i përket shumës së borxhit prej 2,782.90 euro ku kjo shumë e borxhit rrjedh për periudhën kohore prej datës 13.10.2014 e deri më datë 11.05.2018 dhe për këtë pjesë të borxhit gjykata e shfuqizoj urdhrin për përmbarim, për shkak të parashkrimit, kurse e refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar sa i përket shumës së borxhit prej 590.96 euro në të cilën kjo shumë e borxhit të mbetur rrjedh për periudhën kohore prej datës 11.06.2018 e deri më datën 12.06.2019, dhe për shpenzimet e procedurës përmbarimore dhe për këtë shumë të borxhit dhe për shpenzimet e përmbarimit, gjykata vendosi që të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata duke i marr për bazë vërejtjet e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë në aktvendimin Ac.nr.3131/2020, të datës 12.10.2022, në shumën e mjeteve prej 2,782.90 euro, për të cilën e ka shfuqizuar urdhrin për përmbarim dhe në shumën e mjeteve prej 590.96 euro, për të cilën e ka lënë në fuqi urdhrin për përmbarim, e ka bërë precizimin e periudhës kohore, siç është sqaruar më lart.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, si dhe nenit 360, par 1, nën par 1.1, të LMD-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.216/22, më datë 19.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.